

VENDIM
Nr. 100, datë 15.2.2017

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, PËR “ALBCONTROL”, SH.A-NË., TË DISA OBJEKTEVE DHE
SIPËRFAQEVE, TRUALL FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONAVE
NR.223, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR.3028”, ME VENDNDODHJE NË
PORTO-ROMANO, DURRËS, DHE NR.805, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK
NR.6614/5”, ME VENDNDODHJE NË MALIN E KRUIJËS, KRUIJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 12, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për “Albcontrol”, sh.a-në., për një periudhë 30-vjeçare, të disa objekteve dhe të një truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 550 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë) m², brenda territorit të pronës nr.223, me emërtim “Reparti ushtarak nr.3028”, me vendndodhje në Porto-Romano, Durrës, dhe truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 592 (pesëqind e nëntëdhjetë e dy) m², brenda territorit të pronës nr.805, me emërtim “Reparti ushtarak nr.6614/5”, me vendndodhje në Malin e Krujës, Krujë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’u përdorur për instalimin e pajisjeve të survejimit, monitorimit dhe komunikimit nga “Albcontrol”, sh.a-ja., në përputhje me standardet ndërkombëtare, në funksion të navigimit ajror.

2. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe “Albcontrol”, sh.a-së., u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e objekteve dhe të truallit funksional, të pronës nr.223, me emërtim “Reparti ushtarak nr.3028”, me vendndodhje në Porto-Romano, Durrës, dhe të truallit funksional të pronës nr.805, me emërtim “Reparti ushtarak nr.6614/5”, me vendndodhje në Malin e Krujës, Krujë, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, nëpërmjet Komandës së Forcës Ajrore dhe Drejtorisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nëpërmjet “Albcontrol”, sh.a-së., të lidhin marrëveshje të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, drejtori i Përgjithshëm i “Albcontrol”, sh.a-së, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VENDOSJA
e Pronës nr.223" Rep. Usht. Nr.3028 " Porto Romano, Durrës

MIRATOHET
KOMANDANTI I FORCËS AJRORE
Gjeneral Brigade VLADIMIR AVDIAJ

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 8518,3184
Nr.Pasurise _____ Vol. _____ Fq. _____
Indeksi i Hartes K-34-87- (238-A,C)
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurise, Durrës
Q/F Porto Romano, Durrës
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Forcat Ajrore

PUNOI
Ing. Katjusha Hyseni

DREJTORI I IGJIU
N.Kol. Ark. FERDI HYRAJ

Nëntor 2016



SHPJEGUESE

Sip. e përgjithshme = 24 249.8m²

Sip. nën objekt = 894.2 m²

Sip. në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil
(DPAC) për ALBCONTROLL-in = 1 550m² (ku përfshihen 2 tunele
me sip. të 2 tuneleve= 108 m²)

— Kufiri i repartit

Shënim:

Kjo planvendosje u hartua në zbatim të shkresës së Forcës Ajrore
nr.4476/2, datë 14.11.2016, sipas verifikimit në terren dhe bazuar në
planvendosjen e pronës të marrë në arkivin e IGJIU-së.

PLAN VENDOSJA
e Pronës nr.805" Rep. Usht. Nr.6614 " Pika e Malit, Krujë

MIRATOHET
DREJTORI I PËRGJITHSHËMI AISM
Kolonel BARDHYL KOLLÇAKU



DREJTORI I KOLIU
N/Kol. Ark. FERDI HYRAJ



IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 8621
Nr.Pasurise _____ Vol. _____ Fq. _____
Indeksi i Hartes K-34-88- (122-B)
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurise, Krujë
Q/F Pika e malit, Krujë
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, AISM

PUNOI
Topograf Ramiz Hashiu
Nëntor 2016



SHPJEGUESE

Sip. e përgjithshme = 7304 m²
Sip. nën objekt = 128.90 m²
Sip. në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil (DPAC) për ALBCONTROL-in = 592m²
Kufiri i repartit

Shënim: Kjo planvendosje u hartua në zbatim të shkresës së AISM nr.4168, datë 09.11.2016, bazuar në planvendosjen e pronës të marrë në arkivin e IGJIIU-së.

